



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 222/26 Dt. 21.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet furnizimi me karburant-naftë për nevojat e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së-dega në Prizren, Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së-dega në Prizren dhe Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së-dega në Prizren (zhvillimi dhe kryerja e aktiviteteve përkatëse), kështu që, i lejohet furnizimi me karburant naftë-triska si në vijim:
 - 1.1. Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së-dega në Prizren, i lejohet furnizimi me karburant naftë-triska, në sasi prej 100 litra në muaj, përkatësisht 600 litra, për periudhën 6 (gjashtë) mujore.
 - 1.2. Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së-dega në Prizren, i lejohet furnizimi me karburant naftë -triska, në sasi prej 100 litra në muaj, përkatësisht 600 litra, për periudhën 6 (gjashtë) mujore.
 - 1.3. Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së-dega në Prizren, i lejohet furnizimi me karburant naftë-triska, në sasi prej 100 litra për muaj, përkatësisht 600 litra, për periudhën 6 (gjashtë) mujore.
 2. Furnizimi bëhet për periudhën qershor-nëntor 2026.
 3. Furnizimi lejohet të bëhet te operatori ekonomik i cili bën furnizimin e Komunës me karburante.
 4. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet :
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - OVL të UÇK-së,
 - ShIL të UÇK-së,
 - SHFD të UÇK-së,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

